



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Nr. 4351 prot.

Tiranë, më 01.09.2023

NJOFTIM

PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, si dhe vendimin nr.1, datë 21.01.2021 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Lartë, **shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor**, për pozicionin si më poshtë:

- **Për 1 (një) vend**, në pozicionin *specialist*, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë.

Pozicionet më sipër u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele , rezulton se ende ka pozicione vakante ,ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

14.09.2023

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

21.09.2023

Nëpunësi civil gjyqësor (specialist) për marrëdhëniet me publikun kujdeset për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e gjykatës në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nëpunësi krijon dhe ruan marrëdhënie profesionale dhe etike me publikun dhe median si dhe kujdeset për komunikimin e përditshëm me të gjithë përdoruesit e gjykatës në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe median kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësinë dhe të dhënave personale, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë.

Shërbimet e specialistit të marrëdhënieve me publikun dhe median synojnë të garantojnë zbatimin e të drejtës së informimit mbi veprimtarinë e gjykatës në funksion të transparencës që Gjykata duhet të tregojë, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe të drejtën për ruajtjen e të dhënave personale. Specialisti i marrëdhënieve me publikun në ushtrimin e detyrave të tij/saj udhëhiqet nga parimet e parashikuara në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit si dhe atë mbi lirinë e medias.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin specialist i marrëdhënieve me publikun dhe median përfshin por nuk kufizohet në detyrat e mëposhtme:

- a) Vepron si pikë kontakti në pritjen e popullit sipas orarit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës, sqaron të interesuarit (përfituesit e gjykatës) dhe, sipas rastit, vë në dijeni sektorin apo personin zyrtar kompetent të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjes. Ai vepron edhe si pikë kontakti për përfaqësuesit e medias (së shkruar dhe audiovizive) në Republikën e Shqipërisë duke krijuar marrëdhënie korrekte dhe të ndërsjella me ata si dhe zbaton detyrimet që burojnë nga ligji për informimin publik, duke iu përgjigjur interesimit të gjyqtarëve dhe medias për probleme që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë;
- b) Vepron si koordinator në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas udhëzimit të eprorit direkt;
- c) Harton/përgatit përgjigjet me shkrim ndaj kërkesave, ankesave dhe deklarimeve të shtetasve, dhe, kur e gjykon të nevojshme, konsultohet edhe me nëpunësit civilë gjyqësorë të tjerë në Gjykatën e Lartë.
- ç) Kujdeset për mbajtjen dhe ruajtjen e një regjistri të veçantë ku shënohen të gjitha veprimtaritë e ndërmarra: data, subjekti që ankohet, shkurtimi i kërkesës ose ankesës dhe mënyra e veprimit nga sektori;
- d) Përgatit dokumente strategjike dhe/ose politike të gjykatës në lidhje me mënyrën e zhvillimit të mëtejshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve dhe komunikimit me publikun dhe median për të siguruar njëtrajtshmëri dhe mosdiskriminim në trajtimin e të interesuarve (përfituesve) si dhe në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit;
- dh) Harton nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Drejtorisë dhe Gjyqtarit për Median deklarata për shtyp, apo komunikata për shtyp të vizitave apo të shkruar për çështje që i përkasin veprimtarisë së Gjykatës së Lartë dhe i dërgon ato, sipas rastit për botim apo transmetim;
- e) Asiston në konferenca shtypi të Kryetarit, duke siguruar paraprakisht pjesëmarrjen e

medias së shkruar dhe vizive;

ë) Merr pjesë në takime e mbledhje pune në të cilat asiston Kryetarin, merr pjesë në gjykime dhe në shpallje të vendimeve ku ka prani mediatike dhe sipas rastit harton draft njoftimin për publikun dhe median;

f) Merr pjesë në veprimtaritë që organizon Gjykata e Lartë dhe pasqyron, nëpërmjet fotografimit apo xhirimeve filmike, veprimtari të tilla që i shërbejnë historikut të institucionit si: konferenca, simpoziume, takime dhe pritje të delegacioneve, promovimeve dhe përvjetorëve, dekorime dhe çdo veprimtari tjetër të ngjashme;

g) Kujdeset që publikut dhe medias t'i sigurohet informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet dhe çështje të caktuara;

gj) Përgatit çdo dokument tjetër që i kërkohet nga Kancelari ose Këshilli i Gjykatës në lidhje me problematikat e hasura në marrëdhëniet me publikun dhe median;

h) Bashkëpunon me sektorë të tjerë për mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes së internetit të Gjykatës së Lartë;

i) Kryen detyra të tjera, sipas parashikimeve të Rregullores së Gjykatës, urdhrave apo porosive të Kryetarit, Gjyqtarit të medias, Kancelarit dhe Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun.

I. LËVIZJA PARALELE.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** për lëvizjen paralele si më poshtë:

- të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” ose “shumë mirë”.

Kërkesat e veçanta janë të njëjta për të dyja procedurat, lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil:

Arsimi: Të jetë diplomuar në shkencat e komunikimit/gazetari, drejtësi, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshtatshme me përshtatshme me punës të paktën në nivelin ‘Master Shkencor’ ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.

Përvoja: Të ketë përvojë pune të paktën 2 vjet në komunikimin me publikun dhe median. Të ketë kryer të paktën 1 vit praktikë që lidhet me gjykatën dhe procedurat gjyqësore.

- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi me publikun dhe bashkëpunëtorët. Të jetë i gatshëm të bashkëpunojë me kolegët e sektorit ku bën pjesë, si dhe me njësitë e tjera të Gjykatës, me qëllim realizimin e detyrave që i ngarkohen.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, angleze dhe njohuri bazë në një gjuhë të dytë (frëngjisht, italisht);
- Të kenë njohuri teknike të nevojshme për përdorimin e sistemeve bazë të kërkimit online ose në platforma të tjera elektronike;
- Të kenë dëshirë dhe gatishmëri për të arritur nivele më të larta të profesionalizmit duke marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme dhe aktivitete që lidhen me aftësimin e mëtejshëm profesional;
- Të tregojë dëshirë dhe iniciativë për zbatimin e metodave bashkëkohore të punës me qëllim rritjen e efektivitetit të njësisë ku bën pjesë.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **14.09.2023**, pranë Gjykatës së Lartë ose në rrugë postare në adresën : *Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës, (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi , numer kontakti dhe adresë elektronike.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT

Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve minimale për pozicionin e punës dhe kërkesave të veçanta në shpalljen për konkurrim, do të kryhet brenda datës **15.09.2023**, në ambientet e Gjykatës së Lartë, dhe brenda datës **18.09.2023** do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim dhe listat e atyre që nuk i plotësojnë.

Pikët totale për vlerësimin e dokumentacionit janë 70 (shtatëdhjetë) dhe ndahen si vijon:

- a) deri në 30 (tridhjetë) pikë për rezultatet e vlerësimit të punës,
- b) deri në 30 (tridhjetë) pikë për përvojën profesionale lidhur me pozicionin përkatës,
- c) deri në 10 (dhjetë) pikë për trajnimin e lidhur me fushën përkatëse.

I.4. INTERVISTA E STRUKTURUAR ME GOJË

Për intervistën e strukturuar me gojë, kandidatët fitues të fazës së parë, do të informohen nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë. www.gjykataelarte.gov.al dhe nëpërmjet adresës së tyre elektronike.

Pikët totale për vlerësimin e intervistës me gojë janë 30 (tridhjetë) pikë.

Përmbajtja e pyetjeve të intervistës me gojë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë **29.09.2023**.

Në përfundim të daljes së rezultateve të vlerësimit të kandidatëve, njoftimi me emrat e nëpunësve fitues do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së www.klgj.al dhe në faqen web të Gjykatës, www.gjykataelarte.gov.al

Njoftimi dhe komunikimi për kandidatët do të jetë nëpërmjet adresës së e-mail të kandidatit.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për

konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës së Lartë duke filluar nga data **22.09.2023** për pozicionin specialist i marrëdhënieve me publikun, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë.

Ky informacion do të shpallet në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Marrëdhëniet me publikun-Vende vakante”.

II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Kandidatët për pranimin në shërbimin civil gjyqësor për të dy vendet e shpallura duhet të plotësojnë:

Kriteret e përgjithshme si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kërkesat e veçanta janë të njëjta si për lëvizjen paralele (shih më lartë).

II.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **21.09.2023**, në ambientet e Gjykatës së Lartë ose nëpërmjet postës në adresën : *Gjykata e Lartë, Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentet e mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron.
- CV e përditësuar
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës,
- Fotokopje të certifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Dokument që vërteton njohuritë e gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore ,

- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vërtetim nga gjykata
- Vërtetim nga prokuroria

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi (provimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë)

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al duke filluar nga data **26.09.2023**. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës së Lartë individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidateve do të bëhet si më poshtë:

1. 60 pikë për rezultatet e testit me shkrim;
2. 40 pikë nga Komisioni i Pranimit dhe Këshilli i Gjykatës:

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen janë:

- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, mënyra e organizimit të pushtetit gjyqësor (llojet dhe kategoritë e gjykatave, etj)
- aktet nënligjore përkatëse të KLGJ-së për komunikimin me publikun dhe median, kuadri ligjor për të drejtën e informimit, si dhe rregullat e protokollit të shtetit.
- E drejta për informim mbi dokumentet zyrtare dhe Mbrojtja e të dhënave personale;

Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga përfundimi i testimit me shkrim, ftohen kandidatët për intervistë dhe kandidati për vendin e lirë përkatës zgjidhet, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:

- a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim;
- b) 25 pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë,
- c) 15 pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data e daljes së rezultateve do të jetë **16.10.2023**. Pas arsyetimit dhe publikimit të vendimit për rezultatet e procedurës së emërimit nga Këshilli, ky vendim do t’u njoftohet të gjithë kandidatëve. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin në faqen web të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al dhe faqen zyrtare të KLGJ-së, www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë